



VENDIM

Nr.115 Datë 07.10.2013

PËR

**MODIFIKIMIN E LIÇENSËS SË SHOQËRISË “WTS ENERGJI” SH.P.K
ME NR. 16, SERIA PV04P PËR “PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE” NGA HEC “TAMARË”, TË MIRATUAR ME VENDIMIN
E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR 39, DATË 22.07.2004**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Liçensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, si dhe neneve 13; 14 pika 2; 15 pikat 1, 2 /b, 3, 4; të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.10.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k për ndryshimin e liçensës Nr. 16, Seria PV04P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 39, datë 22.07.2004 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k, plotëson kërkesat ligjore siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- ***Neni 15, pika 4, gërma “a”***: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës.
- ***Neni 15, pika 4, gërma “b”***: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim liçense.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të modifikojë liçensën me nr.16, Seria PV04P, për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Hec "Tamarë" me fuqi 150 KW, të miratuar me Vendimin e Bordi i Komisionerëve Nr. 39, datë 22.07.2004.
2. Fuqia e instaluar e Hec "Tamarë", nga 150 KW të bëhet 750 KW.
3. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari në detyrë
Shkëlqim Bozgo**